# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-401372**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kosova rrezikon të mbetet pa president pas 5 tetorit, partitë thirren për kompromis ose zgjedhje të reja |
| ADRESA | `https://lajmi.net/kosova-rrezikon-te-mbetet-pa-president-pas-5-tetorit-partite-thirren-per-kompromis-ose-zgjedhje-te-reja/` |
| BURIMI | lajmi.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 02:29:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 5 shtator 2026, 20:10:16 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `69d93a2d06559152f4c3e63c371edadc7a28fb0081a9be3738eb8829799e0736` |
| TEKSTI | `e2f227a9e3a06e8167054efa203524f6b7dd3501e2834c6a93aebda079314f6f` |
| PAMJA | `2f111d7b6f7c3996d29722c8aa9e1a8e4392b5b731f96297573a74bf2f82365d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d29a8166077084ca8e74621129e8bf4a10d4fc09fc5d8a80989a08cd67916e91` |
| E MËPARSHMJA | `2183dfd3a76c103ea7c8c1cd92abe03565ec65044df48f338d92c581e4a55e47` |
| RRËNJA MERKLE | `00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d29a8166077084ca8e74621129e8bf4a10d4fc09fc5d8a80989a08cd67916e91`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# lajmi.net

Lajmi i ri

# Tragjedi në Rahovec: I mituri humb jetën nga plagët e armës së zjarrit...

# Kosova rrezikon të mbetet pa president pas 5 tetorit, partitë thirren për kompromis ose zgjedhje të reja

# Lajme

**05/09/2026 22:10**

### Njohësit e politikës kërkojnë që partitë politike të vendosin sa më shpejt nëse duan të bëjnë kompromise për zgjedhjen e presidentit apo të shpallen zgjedhjet e reja.

Kjo pasi, sipas tyre, pas 5 tetorit Kosova do të mbetet pa president. Çdo vonesë në formimin e institucioneve para tetorit vlerësohet se do t'i kushtojë vendit me pasoja të reja institucionale e politike.

Kosova po rrezikon të hyjë në një periudhë të re të bllokadës institucionale në mungesë të një konsensusi për zgjedhjen e presidentit.

Në rast se nuk arrihet kuorumi i nevojshëm për çështjen e shefit të shtetit, nga 5 tetori vendi mbetet edhe pa president.

Njohës të fushës thonë se në këtë situatë partitë politike duhet të vendosin sa më shpejt, nëse nuk arrijnë marrëveshje, t'i shpallin zgjedhjet e reja.

Ata paralajmërojnë se një situatë ku Kosova mbetet pa president, do të sillte pasoja politike dhe institucionale për vendin.

"Kjo zgjedhje e këtij presidentit duhet të bëhet para datës 4-5 tetor. Në rast se nuk ndodh kjo, kjo është situatë e paprecedent, e rrezikshme sepse cenon sigurinë kombëtare të Kosovës. Për herë të parë ndodhë që një shtet në Bashkimin Evropian të funksionojë pa asnjë titullar….", ka thënë Vullnet Bugaqku, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës.

Njohësit e fushës thonë se partitë politike nuk duhet të lejojnë që të kalohet më shumë kohë pa institucione funksionale.

"Kur ky debat të shterrohet Kosova le të shkoj në zgjedhje dhe u.d e presidentes të caktoj një datë sa më shpejt për mbajtjen e zgjedhjeve në mënyrë që deri para datës 5 tetor ta kemi një Kuvend të ri, qeveri të re dhe një president që është legjitim dhe legal që votohet nga Kuvendi i Kosovës. Në këso rrethana pas datës 5 tetor ne shkojmë në anarki kushtetuese, nuk do të ketë as kush ti thërras partitë për konsensus", ka thënë Naim Jakaj, hulumtues i lartë i Institutit të Kosovës për Drejtësi

Zvarritja e formimit të institucioneve i ka humbur Kosovës dhjetëra miliona euro nga Plani i Rritjes, derisa ngërçi politik vlerësohet se do ta dëmtojë edhe më shumë vendin.

"Ndërkohë pasojat do të jenë të rënda, siç e përmenda. Financat nga plani i rritjes, financat nga plani i brendshëm, çështjet që lidhen me diplomacinë, shërbimin e jashtëm, me lobimin e Kosovës për aplikim për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe organizata të tjera, veçanërisht në Bashkimin Evropian", ka shtuar Jakaj.

Lëvizjes Vetëvendosje i duhen edhe 6 vota për ta zgjedhur presidentin e ri. Partia Demokratike, Aleanca e 6 deputetë të LDK-së janë deklaruar se nuk do të ofrojnë kontribut në këtë drejtim.

## Artikuj të ngjashëm

September 6, 2026

## “Shpirti i tij në paqe, bashkë me babin” – Motra e...

September 6, 2026

## Tragjedi në Rahovec: I mituri humb jetën nga plagët e armës së zjarrit

September 6, 2026

## Raportohet se kapiteni i Njësive Speciale, Besart Ahmeti, po hetohet për...

September 6, 2026

## Reagim shembullor i Policisë në Gjilan – zyrtarët rrezikojnë jetën për...

September 6, 2026

## Përfundojnë takimet me Putinin dhe Zelenskyn, Witkoff dhe Kushner kërkojnë rikthimin...

September 6, 2026

## Konflikti Rusi-Ukrainë, Shtuni: Tentativa për paqe është e rëndësishme, por ka...

## Lajme të fundit

“Shpirti i tij në paqe, bashkë me babin”...

Tragjedi në Rahovec: I mituri humb jetën nga plagët e armës së zjarrit

Raportohet se kapiteni i Njësive Speciale, Besart Ahmeti,...

Reagim shembullor i Policisë në Gjilan – zyrtarët...

## lajmi.net

[email protected]

Tel: +383 49 131 131

Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

**Rrjetet Sociale**

### Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.